

Anketa e Turizmit “Pushime dhe Udhëtime”

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	5
5. Periudha e referencës	5
6. Mandati institucional.....	5
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshtësia e shpërndarjes.....	7
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	7
11. Manaxhimi i cilësisë	8
12. Rëndësia.....	8
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	9
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	9
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	10
16. Kostoja dhe ngarkesa	10
17. Rishikimi i të dhënave.....	10
18. Përpunimi statistikor	11
19. Komente.....	12
Aneks	12

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Konsumit të Familjeve, Drejtoria e Statistikave Sociale
1.3. Personi i kontaktit	Edlira Subashi
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Statistikave të Konsumit të Familjes
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Njësia Administrative Nr.2, 1017, Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	esubashi@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	29.12.2023
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	29.12.2023
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	29.12.2023
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Anketa e Turizmit pranë Familjeve “Pushime dhe Udhëtime”</p> <p>Anketa e Turizmit në Familje, “Pushime dhe Udhëtime” është një vrojtim statistikor që kryhet pranë njësive ekonomike familjare (NjEF) dhe ka objekt të gjithë individët mbi 15 vjeç me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri.</p> <p>Anketa mbledh të dhëna mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> Udhëtimet me të paktën një natë fjetje për pushime, udhëtime pune dhe udhëtime të tjera, si brenda dhe jashtë vendit, gjithashtu edhe ato brenda ditës brenda/ jashtë vendit të ndarë në katër tremujorë përkatësisht: tremujori i parë (Janar-Mars), tremujori i dytë (Prill-Qershor), tremujori i tretë (Korrik-Shtator), tremujori i katërt (Tetor-Dhjetor). <p>Vizitat një ditore jashtë vendit dhe ato brenda vendit gjatë periudhës referencë.</p> <p>Një modul ad-hoc shtohet në tremujorin e katërt në pyetësor për të</p>

	<p>mbledhur informacione mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrjen në turizëm për qëllime personale gjatë vitit referues. <p>Pyetëtori individual përbëhet nga pesë seksione:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Seksioni I: Karakteristikat Socio-Demografike • Seksioni II: Pjesëmarrja në turizëm • Seksioni III: Numri dhe karakteristikat e udhëtimeve me fjetje • Seksioni IV: Udhëtime një ditore • Seksioni V: Pjesëmarrja në turizëm gjatë vitit 2022 (Moduli Ad-hoc për Tremujorin 4 2022).
3.2. Sistemi i klasifikimit	<p>Klasifikimet statistikore në vijim përdoren për anketën e Turizmit si një model për kodimin e variablave dhe paraqitjen e të dhënave në një mënyrë të renditur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lista e vendeve - ISO 3166, i cili është Standardi Ndërkombëtar për kodet e vendeve që përdoren në nivel ndërkombëtar. - Niveli i Arsimor - Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit (ISCED-2011) është hartuar si një instrument i përshtatshëm për mbledhjen, përpilimin dhe paraqitjen e statistikave të arsimit si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel ndërkombëtar.
3.3. Mbulimi i sektorit	<p>Anketa ka objekt të gjithë individët mbi 15 vjeç me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri, të ndarë sipas gjinisë, grupmoshës (15-24, 25-34, 35-54, 55+) dhe qarkut të vendbanimit.</p>
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p>Mbledhja konsiston në të dhëna për turizmin mbi udhëtimet brenda dhe ato jashtë vendit vetëm në kuadrin e Rregullores (BE) 692/2011 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me statistikat mbi kërkesat e turizmit. Gjithashtu dokument i rëndësishëm për këto statistika është edhe Manuali Metodologjik për Statistikat e Turizmit.</p> <p>Statistikat përfshijnë të dhëna për kërkesat e turizmit (Shtojca II e Rregullores, udhëtime, të dhëna për pjesëmarrje, vizita një ditore).</p> <p>Turist: Një vizitor që qëndron të paktën një natë në akomodim me qira ose pa qira në vendin / vendin e vizituar.</p> <p>Turizmi i brendshëm: Aktivitetet e një vizitori rezident brenda vendit.</p> <p>Turizmi i jashtëm: Aktivitetet e rezidentëve në Shqipëri që udhëtojnë për në, dhe qëndrimi në vende jashtë Shqipërisë si dhe jashtë mjedisit të tyre të zakonshëm.</p> <p>Muaji i nisjes: Udhëtime turistike që fillojnë në një muaj të caktuar dhe që përfundojnë gjatë periudhës së referencës.</p> <p>Numri i netëve: Të gjitha netët turistike të qëndrimit të popullsisë të moshës mbi 15 vjeç, jashtë vendbanimit të tyre të zakonshëm për qëllime personale ose profesionale / biznesi. Një natë turizmi (ose netë qëndrimi) është çdo natë që një vizitor në të vërtetë kalon (fle ose qëndron) ose është regjistruar (prania fizike e tij/saj nuk është e nevojshme) në mjedise akomoduese kolektive ose në akomodim privat të turizmit.</p> <p>Vendi kryesor i destinacionit: Për turizmin vendas, destinacioni kryesor është Shqipëria. Për turizmin e jashtëm, destinacioni mund të kuptohet në mënyra të</p>

	<p>ndryshme: (1) Vendi që vizitori e konsideron si vendin më të rëndësishëm të vizituar (destinacioni motivues); (2) Vendi ku shpenzohet shumica e kohës (destinacioni i kohës); (3) Vendi më i largët i vizituar (destinacioni në distancë).</p> <p>Qëllimi kryesor i udhëtimit: Klasifikimi i udhëtimeve të turizmit sipas qëllimit kryesor: (1) Personal (Pushime, kohë e lirë dhe rekreacion, vizitë miqve dhe të afërme, edukim dhe trajnim, shëndetësi dhe kujdes mjekësor, fe / pelegrinazhe, pazar, tranzit, etj.)) dhe (2) Biznes dhe profesional</p> <p>Mjetet kryesore të transportit: Mjetet kryesore të transportit të përfshira në këtë pyetje janë: Ajri, Uji, Autobusi, Trajler, Makina private ose me qera, makina personale, Biçikleta, motorë , e të tjera.</p> <p>Akomodimi: Mjetet kryesore të akomodimit: hotel ose ambiente të ngjashme; kampe turistike, karvan apo park rimorkio (jo-rezidenciale); shtëpi pushimi, shtëpi njëkatëshe, etj; ambient i specializuar, (banjë ose banjë termale, kamp veror, karrocë gjumi); ambiente akomodimi me qira; shtëpi ose apartamente të dyta për pushime; qëndrim tek të afërmit ose miqtë, tjetër lloj akomodimi.</p> <p>Shpenzimet për udhëtime turizmi: Shpenzimet totale të konsumit të bëra nga një vizitor ose në emër të një vizitori për dhe gjatë udhëtimit të tij / saj dhe qëndrimit në destinacion. Shpenzimet totale ndahen duke ndjekur pikat e shpenzimeve: (1) Paketa turistike, (2) Akomodim, (3) Ushqim, (4) Transport, (5) Shpenzime të tjera, (6) Blerje të pajisjeve afatgjata, (7) Bar-kafe.</p> <p>Gjinia: Vetë-shpjeguese (Burrë ose grua)</p> <p>Mosha: Mosha llogaritet bazuar te data e lindjes.</p>
3.5. Njësia statistikore	<p>Pjesëmarrja në turizëm: Njësia statistikore është individ.</p> <p>Udhëtime për turizëm me netë fjetjeje: Njësia statistikore është udhëtimi me të paktën një natë qëndrim të kryer nga individ.</p> <p>Vizitat një ditore: Njësia statistikore është udhëtimi një ditor i kryer nga individ.</p> <p>Të gjithë personat në familjen e zgjedhur (brenda moshës së synuar, 15 vjeç e lart). Njësia raportuese është i anketuari i përzgjedhur për intervistë.</p>
3.6. Popullata statistikore	<p>Popullata statistikore është të gjitha familjet rezidente shqiptare. Kampioni i vrojtimit përfshin të gjithë territorin e Shqipërisë.</p>
3.7. Zona e referencës	<p>Kampioni i vrojtimit përfshin të gjithë territorin e Shqipërisë. Kampioni përfaqëson të gjithë popullatën, si dhe grupet më tipike të saj. Familjet kolektive nuk janë përfshirë në këtë studim. Shtëpitë e të moshuarve, shtëpitë për fëmijë me aftësi të kufizuara, bujtinat studentore, hotelet, kazermat e ushtarëve, spitalet, sanatoriumet, institucionet e burgjeve, etj. janë përjashtuar nga anketimi. Personat prezent në familje të moshës 15 vjeç e lart.</p>
3.8. Mbulimi në kohë	<p>Anketa e Turizmit në Familje “Pushime dhe Udhëtime” realizohet në baza tremujore përgjatë gjithë vitit kalendarik dhe duke filluar nga viti 2017 anketa është e vazhdueshme.</p>

3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	<p>Të anketuarit e përzgjedhur për intervistë do të raportojnë për udhëtimet me ose pa fjetje të kryer gjatë periudhës së referencës dhe do të japin detaje për karakteristikat e ndryshme të udhëtimit. Çdo udhëtim i vrojtuar është një rekord individual në skedarin e transferuar të të dhënave mikro. Të dhënat për shpenzimet në udhëtimet e turizmit shprehen në lekë të reja.</p> <p>Pjesëmarrja në të dhënat e turizmit transmetohet në formën e tabelave të agreguara me vlera absolute që përfaqësojnë vendbanuesit në Shqipëri, të moshës 15 vjeç e sipër, që marrin pjesë në turizëm.</p> <p>Karakteristikat e vizitave një ditore transmetohen në formën e të dhënave të agreguara me vlera absolute që përfaqësojnë numrin e udhëtimeve një ditore nga vendbanuesit në Shqipëri. Shifrat e shpenzimeve shprehen në lekë.</p>
5. Periudha e referencës	Periudha referuese e këtij raporti është viti kalendarik, Janar - Dhjetor 2022.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore në nivel Kombëtar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • LIGJ Nr. 17/2018 • Programin Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026 <p>Baza ligjore në nivel Europian:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Regulation 692/2011 • Regulation 1051/2011
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Shkëmbimi i të dhënave ka filluar në 30 qershor 2018 për të dhënat e anketës së kryer në vitin 2017 në nivel Evropian. Nga viti 2018 të dhënat për treguesit kryesorë transmetohen rregullisht në Eurostat.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat e mbledhura nga NjEF konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit.</p> <p>Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të

	<p>cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesit tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojnë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojnë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vërtetuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p> <p>Të gjitha të dhënat individuale të mbledhura nga njësia statistikore për nxjerrjen e statistikave zyrtare përdoren vetëm për qëllime statistikore. Këto të dhëna botohen vetëm bashkërisht dhe nuk përdoren për të marrë ndonjë vendim administrativ, duke përfshirë këtu vendime për kontrollin fiskal ose hetime juridike.</p>
<p>8. Politika e botimit</p>	
<p>8.1. Kalendarin e publikimeve</p>	<p>Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendarin. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.</p>
<p>8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve</p>	<p>Kalendari i Publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT-it.</p>
<p>8.3. Aksesin e përdoruesve</p>	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias. INSTAT-i dhe agjencitë, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta.</p> <p>Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e vërtetimit të Anketa e Turizmit “Pushime dhe Udhëtime” janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Website – online release 2. Databaza Statistikore 3. Kërkesat e shkruara 4. Publikimet

	5. Pjesa e Informacionit e dedikuar për të kontaktuar INSTAT.
9. Shpeshhtësia e shpërndarjes	Rezultatet e statistikave të Anketës së Turizmit “Pushime dhe Udhëtime” janë publikuar në baza vjetore.
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	<p>Njoftimi për shtyp përmban informacione për treguesit kryesorë:</p> <p>lidhur me udhëtimet e kryera sipas qëllimit/udhëtime të shkurtra/të gjata/brenda dhe jashtë Shqipërisë, profili i udhëtarëve (gjinia/grupmosha etj) për udhëtime të kryera brenda dhe jashtë vendit, udhëtimet sipas destinacioneve dhe tremujorëve, udhëtimet sipas llojit të akomodimit/transportit, udhëtimet një ditore (vajtje-ardhje) dhe udhëtimet sipas vendit të origjinës.</p> <p>Njoftimi për shtyp i statistikave të turizmit "Pushime dhe Udhëtime" është botuar në faqen e internetit të INSTAT.</p>
10.2. Publikime	Statistikat e Turizmit gjenden të botuara në Vjetarin Statistikor, atë Rajonal, botimin e dedikuar “Turizmi në Shifra” si dhe në botimin “Shqipëria në Shifra”. Përdoruesit mund t’i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT: Anketa e Turizmit - Pushime dhe Udhëtime
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënave mbi statistikën e turizmit "Pushime dhe udhëtime" e aksesoni në linkun Databaza .
10.4. Aksesit në të dhënat mikro	Të dhënat në nivel mikro për Anketën e Turizmit “Pushime dhe Udhëtime” nuk bëhen të disponueshme, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 31, pika 7 ligji nr. 17/2018, datë 17.04.2018 "Për statistikën zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për Kontakt .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me Metodogjinë mbi vrojtimin.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Spektori i Statistikave të Konsumit të Familjeve, dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat për qëllime të brendshme.

11. Manaxhimi i cilësisë

11.1. Sigurimi i cilësisë	<p>INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “Për statistikave Zyrtare”, Nr.17/2018, datë 17.04.2018”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.</p>
11.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Cilësia e të dhënave është shumë e mirë dhe nuk ka nevojë për imputim. Të gjitha kërkesat e përcaktuara me Rregulloren 692/2011 janë marrë në konsideratë.</p> <p>Validimet e ndërtuara në programin e mbledhjes së të dhënave.</p> <p>Janë bërë një numër minimal intervistash me autorizim në mënyrë që të zvogëlohen efektet e mos-përgjigjes për shkak të moshës dhe kushteve shëndetësore të lidhura me plakjen. Kurdo që të jetë e mundur, intervistuesit udhëzohen të intervistojnë individët e zgjedhur; megjithatë disa individë nuk janë në gjendje të kryejnë një intervistë për shkak të pamundësisë fizike ose konjitive. Prandaj, intervistat me autorizim lejohen vetëm kur intervistuesi ka shqetësime në lidhje me aftësinë e të anketuarit për të dhënë informacion të saktë.</p>
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e Anketa e Turizmit “Pushime dhe Udhëtime” ndahen në përdorues të brendshëm dhe të jashtëm.</p> <ul style="list-style-type: none">✓ Me përdorues të jashtëm nënkuptojmë:<ul style="list-style-type: none">• Institucione të administratës publike• Universitetet• Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare• Bizneset• Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme.✓ Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT të cilët përdorin rezultatet e Anketa e Turizmit “Pushime dhe Udhëtime” si input në punën e tyre.<ul style="list-style-type: none">• Drejtorja e Llogarive Kombëtare• Drejtorja e Statistikave Ekonomike.
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikimet (Page Views) në lidhje me Statistikat e Anketës së Turizmit “Pushime dhe udhëtime” për vitin 2022 janë rreth 2.126 klikime.</p> <p>Gjatë vitit 2022, INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së</p>

	<p>përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e Statistikave për Anketën e Turizmit “Pushime dhe udhëtime” është vlerësuar me 3,58 (71,6%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon cdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Të dhënat e Anketës së Turizmit “Pushime dhe udhëtime” 2022 janë në përputhje me kërkesat e Rregullores për statistikën e turizmit 692/2011, rekomandimet e përcaktuara në Manualin Metodologjik dhe me Programin e Statistikave Zyrtare për statistikën e turizmit.</p> <p>Plotshmëria e të dhënave, për “Anketën e Turizmit - Pushime dhe udhëtime” merr në konsideratë sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT kundrejt atyre që kërkohen nga PSZ. Shkalla e Plotshmërisë për vitin 2022 rezulton të jetë 100 %.</p>
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Procesi i hedhjes së të dhënave, është i programuar që minimizojë gabimet që vijnë nga procesi i mbledhjes së të dhënave. Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave merr masa për të reduktuar mos-përgjigjet. Të dhënat e mbledhura krahasohen në lidhje me koherencën e brendshme, burimet administrative apo anketat e tjera pranë familjeve që INSTAT realizon duke garantuar një produkt final cilësor.</p> <p>Çdo anketë e zhvilluar nga INSTAT bazohet në zgjedhjen e një kampioni për të nxjerrë përfundime për popullsinë në studim. Natyrshëm, ky proces shoqërohet me devijime statistikore. Për këtë arsye u llogariten devijimet standarde të zgjedhjes të cilat përdoren për interpretimin e rezultateve të anketës.</p>
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Për Anketën e Turizmit “Pushime dhe Udhëtime” 2022, janë vlerësuar devijimet standarde të kampionit për treguesit kryesorë. Tabelat në Aneks japin vlerësimet për treguesit kryesorë së bashku me devijimet standarde dhe koeficientët e variacionit.</p>
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Mos-përgjigja në nivel rekordi merr në konsideratë familjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur familjet, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën. Shkalla e mos-përgjigjes nivel rekordi e papeshuar është 28,7%.</p> <p>Shkalla e mbi-mbulimit, tregon se sa përqind e familjeve nuk duhet të ishin pjesë e anketës, pasi janë jashtë fokusit të anketës. Shkalla e mbi-mbulimit për Turizëm 2022 është 3,5%.</p>
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e Anketa e Turizmit “Pushime dhe Udhëtime” janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 317 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T+ 317 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Anketa e Turizmit “Pushime dhe Udhëtime” është 31 Dhjetori 2022.</p>

	<table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>11/13/2023</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>317</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2022	Data e publikimit	11/13/2023	Afatet kohore	317		
Periudha referuese	12/31/2022								
Data e publikimit	11/13/2023								
Afatet kohore	317								
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat e Anketa e Turizmit “Pushime dhe Udhëtime”, publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>11/13/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>11/13/2023</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2022	Data e shpallur	11/13/2023	Data e publikimit	11/13/2023	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2022								
Data e shpallur	11/13/2023								
Data e publikimit	11/13/2023								
Vonesa në kohë	0								
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria									
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Të dhënat mbi Turizmin janë hartuar në përshtatje me metodologjinë e Eurostat dhe si të tilla janë të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. Të dhënat janë gjithëpërfshirëse dhe prodhohen në nivel vendi.								
15.2. Krahasueshmëria kohore	Viti 2017 është viti i parë i kryerjes së vrojtimit. Metodologjia ndër vite është përgjithësisht e njëjta duke siguruar nje krahasueshmëri kohore prej 6 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=6).								
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	<p>Kontrolle të rregullta të ndërthurura realizohen me informacione nga burime të tjera të INSTAT pasi rezultatet e këtij vrojtimi përdoren gjithashtu për të krahasuar statistikat e turizmit nga burime të ndryshme.</p> <p>Për më tepër, shifrat zyrtare të popullsisë sipas gjinisë dhe moshës janë përdorur për të bërë kalibrimin e vrojtimit dhe për të marrë faktorë më të saktë të ngritjes.</p>								
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar para se të finalizohet.								
16. Kostoja dhe ngarkesa	<p>Personat që punojnë për vrojtimin e Turizmit “Pushime dhe Udhëtime” janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Stafi i përgjithshëm në Zyrat Qendrore: 3 punonjës • Stafi në Zyrat Rajonale, 28 punonjës • Intervistuesit, Operator, Kontrollor (Staf i përkohshëm i INSTAT): 50 Intervistues + 3 Kontrollorë + 4 Operatorë. 								
17. Rishikimi i të dhënave									
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit të Turizmit “Pushime dhe Udhëtime” bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e Revizionimit • Politika e trajtimit të Gabimeve 								
17.2. Praktika e rishikimit	Nuk janë kryer rishikime mbi të dhënat e Anketës të Turizmit “Pushime dhe Udhëtime”, për vitin 2022, subjekt i këtij raporti.								

18. Përpunimi statistikor

18.1. Burimi i të dhënave	<p>Burimi i vetëm i mbledhjes së të dhënave është Sondazhi mbi Turizmin "Pushime dhe Udhëtime". Si frame i Popullsisë ka shërbyer CENSUS i Popullsisë 2011. Madhësia e kampionit bruto për Anketën e Turizmit 2022 ka qenë 10.240 familje. Në përfundim të vrojtimit u intervistuan rreth 7.298 NjEF të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë territorin e Shqipërisë. Shkalla e përgjigjes së NjEF, e llogaritur si raport i numrit të NjEF që kanë plotësuar anketën ndaj numrit të NjEF të zgjedhura, shprehur në përqindje rezultoi 71,3%.</p> <p>Dizenjimi i kampionit u bazua në:</p> <ul style="list-style-type: none">• 4 kampione të pavarur nga 2.560 familje. Janë anketuar të gjithë personat prezent në familje të moshës 15 vjeç +.• Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure dy-hapëshe. <p>Procedura e zgjedhjes së kampionit e shtresuar me dy faza.</p> <ul style="list-style-type: none">• Faza e parë - Zgjedhja e kampionit për nr e zonave të Censit (EA), me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së Censit (PPS - bazuar në madhësinë sipas numrit të NjEF).• Faza e dytë - Përzgjedhja sistematike e rastit me probabilitet të barabartë, e një numri fiks prej 8 NjEF brenda secilës prej zonave të zgjedhura në hapin e parë (rendi gjeografik).
18.2. Shpeshësia e grumbullimit të të dhënave	<p>Të dhënat grumbullohen në baza tremujore. Pjesëmarrja në turizëm në vitin referues mblidhet vetëm një herë në vit gjatë mbledhjes së të dhënave të tremujorit të referencës.</p>
18.3. Grumbullimi i të dhënave	<p>Informacioni statistikor mbi turizmin mblidhet bazuar në anketimin e individëve. Mbledhja e të dhënave bazohet në një intervistë të drejtpërdrejtë përmes intervistuesve në muajin pas periudhës së referencës në të cilën përfundojnë intervistat. Për mbledhjen e të dhënave përdoret metoda PAPI.</p>
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	<p>Sa i përket vlefshmërisë së të dhënave, procedurat e editimit të të dhënave në përgjithësi i referohen editimit në nivel mikro ose ndryshe në nivel NjEF.</p> <ol style="list-style-type: none">1. Kontrolli cilësor dhe sasior (fizik) i pyetësorit.<ul style="list-style-type: none">• Kontrolli i pyetësorëve të mbledhur, kontrole të tërësisë së plotësimin, saktësisë së vlerave dhe kontrollit logjik i pyetësorit. Stafi kontrollues ka një program specifik për të kryer kontrollin fizik të pyetësorëve. Numri i pyetësorëve të mbledhur duhet të jetë i barabartë me numrin e pyetësorëve të shpërndarë në qarqe.• Kontrole individuale janë bërë për rastet e refuzimit dhe pa kontakte.2. Korrigjimet aritmetike, korrigjimet logjike dhe verifikim i koherencës midis pjesëve të ndryshme të pyetësorit.<p>Të dhënat fillestare kontrollohen më tej për mospërputhjet dhe vlerat që mungojnë. Vlerat që mungojnë për shpenzime janë imputuar duke përdorur modele regresioni bazuar në destinacionin, muajin e nisjes, llojin e ndryshimeve të akomodimit dhe transportit (këto variabla janë fusha të</p>

	<p>detyrueshme në pyetësor). Monitorimi i ambienteve të jashtme duke përfshirë kohëzgjatjen e qëndrimit dhe kategoritë e shpenzimeve. Të dhënat validohen plotësisht duke përdorur SPSS për të siguruar cilësi dhe qëndrueshmëri të rezultateve. Këto rregulla bazohen kryesisht në përkufizimet e dhëna në manualin metodologjik të përgatitur nga Eurostat.</p>								
<p>18.5. Përpilimi i të dhënave</p>	<p>Për përpilimin e rezultateve kemi dy procedura bazë:</p> <p>1. Analiza e cilësisë së të dhënave Për të analizuar cilësinë e të dhënave janë aplikuar disa rregulla:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli matematik i anketës • Kontrolli logjik i të dhënave të anketës • Krahasimi i të dhënave me skedarë të tjerë të disponueshëm në INSTAT <p>2. Trajtimi i mos-përgjigjeve Konsiderohen si mos-përgjigje të gjitha rastet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pa kontakt • Refuzim i plotë <p>3. Imputimi Vlerat që mungojnë për shpenzime janë imputuar duke përdorur modele regresioni bazuar në destinacionin, muajin e nisjes, llojin e variablave të akomodimit dhe transportit (këto variabla janë fusha të detyrueshme në pyetësor).</p> <p>4. Procedura e peshimit: Pesha NjEF = pesha e dizenjimit * pesha e mos-përgjigje * pesha e rregulluar Pesha e dizenjimit: inversi i probabilitetit të zgjedhjes Pesha e mos-përgjigjes: inversi i probabilitetit të përgjigjes së vlerësuar Pesha e rregullimit: kalibrimi me burimet e jashtme.</p> <p>Kalibrimi në:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Grup moshë (15_24, 25_34, 35_44, 45_54, 55_64, 65_) 2. Meshkujt_Gjithsej_15 3. Femra_Gjithsej_15 4. 1 janar 2021 Popullata NjEF shqiptare <p>Në nivelin e NUT_2 / Urban / Rural.</p>								
<p>18.6. Rregullimi</p>	<p>Nuk aplikohet. Asnjë përshtatje sezonale nuk i bëhet të dhënave të grumbulluara nga Anketa e Turizmit “Pushime dhe Udhëtime”.</p>								
<p>19. Komente</p>									
<p>Aneks</p>									
<p>Më poshtë jepen vlerësimet për numrin e udhëtimeve së bashku me devijimet standarde dhe koeficientët e variacionit sipas kategorive përkatëse.</p> <p>Tabela A1 – Treguesit e saktësisë për shpërndarjen e udhëtimeve brenda dhe jashtë Shqipërisë</p>									
	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 25%;">Vlerësimi i nr të</th> <th style="width: 25%;">Devijimi</th> <th style="width: 25%;">Intervali i besimit 95%</th> <th style="width: 25%;">Koeficienti</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> </tbody> </table>	Vlerësimi i nr të	Devijimi	Intervali i besimit 95%	Koeficienti				
Vlerësimi i nr të	Devijimi	Intervali i besimit 95%	Koeficienti						

	udhëtimeve	Standart	I poshtëm	I sipërm	i variacionit
Në Shqipëri	3.024.571	138.159	2.753.460	3.295.682	4,6
Jashtë Shqipërisë	722.422	48.916	626.434	818.410	6,8
Gjithsej	3.746.993	155.268	3.442.310	4.051.677	4,1

Tabela A2 - Treguesit e saktësisë për shpërndarjen e udhëtimeve sipas llojit të tyre

	Vlerësimi i nr të udhëtimeve	Devijimi Standart	Intervali i besimit 95%		Koefficienti i variacionit
			I poshtëm	I sipërm	
Për qëllime personale	3.650.587	152.259	3.351.808	3.949.366	4,2
Për qëllime biznesi	96.407	13.426	70.061	122.752	13,9
Gjithsej	3.746.993	155.268	3.442.310	4.051.677	4,1